

ndërroi jetë po atë ditë. Maxhuni u varros në varrezat e Irzniaq/Rznić më 11.08.1998. Gëzimi u varros në varrezat e Baranit/Barane [Pejë/Peć], ditën e nesërme. Në datën 11.09.1999, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Irzniaq/Rznić.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; deklarata Z.S, FDH-12766.

## Misin (Avdyl) Jasiq

(1924, shqiptar nga Gramaçeli/Gramoçelj, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, shtatë fëmijë)

Familja e Misinit e ka braktisur fshatin [Gramaçel/Gramoçelj] më 11.08.1998 dhe ka kaluar në fshatin Jasiq/Jasić, por ai ka refuzuar të niset me familjarët e tij. Kishte probleme më këmbë, nuk mundte të ec-te shpejt. Dy ditë më vonë, familjarët kanë mësuar nga fqinjët, të cilët u kthyen në fshat për të parë nëse shtëpitë e tyre ishin dëmtuar nga luftimet, se Misinin e kishin vrarë dhe se trupi i tij gjendej në një livadh në afërsi të shtëpisë së tyre. Në mbrëmje, djemtë e tij Xhevati dhe Faiku, së bashku me farefisin, kanë shkuar në Gramaçel/Gramoçelj për të marr trupin e Misinit. E çuan në fshatin Firajë/Firaja. Të nesërmen, më 14.08.1998, e kanë varrosur Misinin në varrezat e fshatit Dujakë/Dujak. Pas përfundimit të luftës, më 18.04.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Misinit në varrezat e fshatit Gramaçel/Gramoçelj.

**Burimi:** deklarata N.J, FDH-19230.

## Bratislav (Dušanka) Ilić

(3.10.1972, serb nga Prokupla, anëtar i UJ-së)

Bratislavi ka qenë komandant i njësitit 352 të brigadës së xhenios të UJ-së. E kanë vrarë më 11.08.1998 në Gramaçel/Gramoçelj, gjatë luftimeve me forcat e UÇK-së.

**Burimet:** SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 29; KKKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817.

## Xheladin (Sahit) Mushkolaj

(3.11.1939, shqiptar nga Gramaçeli/Gramoçelj, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, gjashtë fëmijë)

Kur forcat serbe e sulmuan fshatin Gramaçel/Gramoçelj më 9.08.1998, bashkëshortja e Xheladinit, Gjykja dhe vaj-zat Nergjivana dhe Antigona e kanë braktisur fshatin, ndërsa Xheladini ka mbetur vetëm në shtëpi. Tri ditë më vonë, familja ka mësuar se Xheladini ka pësuar në **Irzniaq/Rznić** gjatë bombardimit të fshatit, më 11.08.1998. Një ditë më vonë, më 12.08.1998, të afërmit e Xheladinit, me ndihmën e pjesëtarëve të UÇK-së, e kanë varrosur Xheladinin në varrezat e Isniaq/Istinić. Familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Xheladinit në varrezat e Gramaçelit/Gramoçelj në vitin 2000.

**Burimet:** deklarata G.M, FDH-19244; deklarata N.A, FDH-12766.

## Hyrë (Dinë) Tahiraj

(1913, shqiptare nga Baballoqi/Babaloc, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, një fëmijë)

E moshuara Hyre ka qenë shumë e sëmurë dhe lëvizte me vështirësi kur filloi lufta. Për të kujdeseshin i biri Ahmeti me bashkëshorten Shqipen. Në datën 12.08.1998, nga ora 10:00, forcat serbe e nisën bombardimin e fshatit [Baballoq/Babaloc]. Ahmeti gjendej duke punuar në fushë që nga mëngjesi. Dukejherë pas fillimit të bombardimeve, bashkëshortja e Ahmetit, Shqipja, i ka çuar fëmijët në fushë te Ahmeti. Ai i ka drejtuar që tu bashkëngjiteshin vendasve që shkonin drejt Gramaçelit/Gramoçelj, ndërkaq ai u kthye në shtëpi që ta merrte të ëmën. Në mbrëmjen e së njëjtës ditë, Ahmeti ka arritur te Baballoqi/Babaloc. Në fshat gjendeshin forcat serbe dhe ai nuk ka mundur të hynte në fshat. Ka parë se shtëpinë e tij e kishte kapluar zjarri. Dy ditë më vonë, kur forcat serbe u tërhoqën, Ahmeti me komshiun Hasim Humën u kthye në fshat. Në korridorin e shtëpisë së djegur e ka gjetur trupin e karbonizuar të së ëmës. E ka mbështjell me batanije trupin e nënës dhe e ka varrosur në vendin e quajtur *Livadhet e Egra/Divlje Livade*, i cili ishte në pronë familjare. Ajo prehet atje edhe sot.

**Burimet:** deklarata Sh.T, FDH-40595; J. Osmani, *Krimet...*, I, 134.